



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Datë/a:	06.07.2021
Referenc-ë:	07-353/04-136273/21
Për/ Za/ To:	“Gjirafa INC”- Adele Gjoka
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-136273/21 nga “Gjirafa INC” me përfaqësuese Adele Gjoka – Menaxhere e produksionit me të cilën kërkohet që me datë 17 Korrik 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike, në rrugën “Bejtush Gërbeshi” në Zllatarrë nga ora 22:00 deri në 07:00. Qëllimi i kërkesës është xhirimi i filmit “Rrushe”.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin “Gjirafa INC për shfrytëzimin e hapësirës publike në rrugën “Bejtush Gërbeshi” në Zllatarrë me datë 17 Korrik 2021 nga ora 22:00 deri në 07:00 për xhirimin e filmit “Rrushe” sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.